



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
 Centralna Izborna Komisija
 Central Election Commission



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 11

Datë: 17. 03. 2022. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Alim Rama, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiši, Rifat Krasniq, Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Nexhmedin Hyseni, drejtor i ZRPP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit Nr.1, dhe 09/2022:

3. Aktivitetet e SKQZ:

4. Aktivitetet e ZRPPC:

- Rekomandimit për dërgimin e Raporteve të Auditimit të partive Politike për vitin 2018-2020 në ATK

5. Raport i Këshillave të KQZ-së:

- **Këshilli për Çështje Ligjore:**

-Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal, në Rahovec dhe Gjakove

-Njoftim për dërgimin e Raporteve të Auditimit të partive Politike për vitin 2018-2020 në ATK

- **Këshilli për Buxhet dhe Financa:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të KQZ-së për vitin 2023-2025

- **Këshilli për Operacione Zgjedhore**

- Shqyrtimi dhe miratimi i Plani i Veprimit i KQZ për adresimin e rekomandimeve të MVZ të BE-së zgjedhjet lokale 2021

6. Të ndryshme.

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kreshnik Radoniqi: Ju përshëndes, jemi të gjithë në mbledhje. Agjendën e keni përpara, a ka dikush diçka, ndonjë propozim...?

Arianit Elshani: Kërkoj që të largohet nga rendi i ditës pika e KOZ “ Shqyrtimi dhe miratimi i Plani i Veprimit i KQZ për adresimin e rekomandimeve të MVZ të BE-së zgjedhjet lokale 2021” për shkak se, nuk është mbajtur takimi i KOZ dhe, nuk është shqyrtuar.

Ilir Gashi: Ndoshta, do të na njoftoni rreth votimit për ACEEEO ?

Alim Rama: Te pika 4, “Rekomandimit për dërgimin e Raporteve të Auditimit të partive Politike për vitin 2018-2020 në ATK”, përsëri më duket se është njoftim për të njëjtat raporte, sepse është te këshilli për çështje ligjorë, kështu që mendoj që një çështje nuk ka nevojë me u trajtua në dy pika !

Kreshnik Radoniqi: Po, atëherë e heqim te këshilli për çështje ligjore...! Në rregull, me këto ndryshime kush është për rendin e ditës ?

Miratohet rendi i ditës.

Në vazhdim të mbledhjes, miratohen procesverbalet nr.1, dhe 09/2022 të mbledhjeve të KQZ-së, me një votë abstenim.

Pastaj, kryesuesi, **Kreshnik Radoniqj**, e njoftoi në vazhdim KQZ-në lidhur me ACEEEO-në se kjo organizatë, është shpërbërë në heshtje. Megjithatë, kjo ka ndodhur për shkak se procesi i votimit nuk ka pasur sukses, pra nuk kanë votuar 2/3 për pezullimin e Rosisë dhe Bjellorusisë. Sipas kërkesës së Sekretariatit, deri më 11 mars është kërkuar që të votohet dhe meqë, s'ka votuar askush kjo organizatë është shpërbërë!

2.Aktivitetet e SKQZ

Burim Ahmetaj, tha se ndryshim - plotësimi i rregullave zgjedhore, është aktivitet në planin e punës së KQZ-së për vitin 2022, i cili parashihet të realizohet nga muaji shkurt deri në muajin prill. Sekretariati ka zhvilluar takime të shumta për realizimin e këtij aktiviteti. Deri me datë 28 shkurt, të gjitha Departamentet dhe Njësitë kanë identifikuar të gjitha Rregullat Zgjedhore të cilat kanë nevojë për plotësim - ndryshim. Bazuar në Vendimin e KE-së të datës 23.02.2022, Nr.343/2022, është formuar grupi punues për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullave Zgjedhore. Deri më tani, janë shqyrtuar dhe trajtuar shtatë (7) rregulla: 1. Rregulla Zgjedhore Nr.01/2013 për Regjistrimin dhe veprimin e Partive Politike. 2. Rregulla Zgjedhore Nr.08/2013 Certifikimi i Subjekteve Politike dhe i Kandidatëve të Tyre. 3. Rregulla Zgjedhore Nr. 01/2020 për Fletëvotime dhe Broshura. 4. Rregullën Zgjedhore Nr.08/2013 Certifikimi i Subjekteve Politike dhe i Kandidatëve të Tyre. 5. Rregullën Zgjedhore Nr. 07/2013 Vëzhguesit e Zgjedhjeve. 6. Rregulla Zgjedhore Nr.12/2013 Kufizimi i Shpenzimeve të Fushatës dhe Deklarimi Financiar. 7. Rregulla Zgjedhore Nr. 14/2013 Financimi i Subjekteve Politike dhe Sanksionet.

Gjatë këtij procesi, tha z. Ahmetaj, është identifikuar nevoja për draftimin e një rregulle të re e cila do të rregullojë procesin e transmetimit dhe publikimit të rezultateve preliminare dhe për këtë është krijuar një komision për draftimin e kësaj rregulle. Ju informoj se grupi punues, po punon vazhdimisht për shqyrtimin dhe trajtimin e të gjitha rregullave zgjedhore.

Në vazhdim të paraqitjes së raportit të tij lidhur me aktivitetet e Sekretariatit në mes të dy mbledhjeve, Ahmetaj tha se zyrat e KKZ-ve nëpër komuna, pothuajse në shumicën prej tyre përkrahen nga komunitatet nga të cilët, ata vijnë duke ofruar zyre në objektet e komunës, si dhe përkrahje logjistike. Në shumicën e komunave, zyrat e KKZ-ve, aktualisht të ZLKZ-ve, janë të vendosura në objekte tjera të komunës por ato nuk janë të lidhura me administratën e komunës. Aktualisht, sipas raportimeve nga terreni, Komuna e Obiliqit për të cilën është kërkuar nga Komuna që ti ndërrohet lokacioni, Sekretariati i KQZ-së, ka kërkuar nga Komuna që të gjendet një lokacion i përshtatshëm në objektet e Komunës së Obiliqit. Po ashtu në Komunën e Lipjanit, në lokacionin ku ka qenë e vendosur zyra e KKZ-së në Lipjan është në procesin e

rrënimit, dhe lidhur me këtë do ti drejtohem Komunës për gjetjen e një lokacioni të përshtatshëm në objektet e Komunës.

Krye shefi Ekzekutiv ka kërkuar nga Drejtori i Koordinimit në Terren një vlerësim nga secila Komunë lidhur me kushtet dhe vendimet për shfrytëzimin e atyre zyrave nga secila Komunë. Pos kësaj kam kërkuar edhe një raport se cilat zyre të KKZ-së shfrytëzojnë shërbimet e internetit nga Komuna në mënyrë që para se të zhvillohen vizitat e parapara me planin e punës nëpër secilën Komunë, do të na shërbejnë si kërkesa të cilat do të mund ti adresonim tek Kryetarët e Komunave për përkrahje.

Ju njoftoj se në zyrën në Lipjan është caktuar zyrtari nga Ferizaji që do të hapë zyrën një ditë në javë ndërsa në Mamushë është caktuar zyrtari nga Prizreni, ndërsa në zyrën në Fushë Kosovë, për arsye të pushimit të lehonisë, është caktuar zyrtari i Obiliqit i cili do të hapë zyrën një herë në javë. Ndërsa në komunën e Podujevës, jemi në procesin e riparimit dhe funksionalizimit të zyrës nga Komuna

Aktiviteti i Planit të punës së KQZ-së 2022, për forcimin e komunikimit ndërmjet ZLKZ-ve dhe Sekretariatit i cili përkrahet nga OSBE-ja, i paraparë të organizohet me datë 22 mars 2022, për arsye objektive që është mungesa e lokacionit disponueshëm me atë datë, është shtyrë me datë 23 mars 2022. Ky, edhe është takimi i parë nga katër takimet që janë të planifikuara sipas Planit të Punës së KQZ-së 2022, tha Ahmetaj.

Në funksion të realizimit të aktivitetit numër 1, nga Plani i Punës i KQZ – së 2022, “Analizë e votave me asistencë për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021”, grupi punues deri më tani ka bërë nxjerrjen e numrit të votave me asistencë për 2,314 vendvotime. Shprehur në përqindje, i bie se për 93.41% të vendvotimeve. Raporti, parashihet të përfundojë në muajin qershor 2022.

Në vazhdim të raportit mbi aktivitetet e SKQZ-së, z. Ahmetaj tha se USAID-i, i është drejtuar me e-mail Sekretariatit për një takim lidhur me përkrahjen e Kosovës në fushën e Qeverisjes Digjitalë apo E-qeverisjes. Sipas kërkesës, USAID, është në fazë të hulumtimit të gjendjes së Qeverisjes digjitalë apo E-Qeverisjes në Kosove, si dhe të explorimit të mundësisë që ky agjencion të kyqet në përkrahjen e Kosovës, në këtë fushë, në të ardhmen e afërt. Një ekip, nga Washingtoni, do të jetë në Kosovë nga data 17 mars deri me 24 mars, për të bërë vlerësimin e sektorit, sfidat dhe rekomandimet për kyqjen eventuale të USAID-it në përkrahje. Propozimi për takim, është data 18 mars 2022, të cilën zyra e Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ-së e ka konfirmuar dhe takimi, do të zhvillohet në zyrat e KQZ-së në Prishtinë.

Në vazhdim të referimit të tij, z. Ahmetaj tha se me qëllim të funksionalitetit dhe të mos ngecjeve në punë, për një periudhë të përkohshme, Kryeshefi Ekzekutiv në bazë të autorizimeve ka caktuar ushtrues detyre për 3 pozita vakante. Në pozitën e Udhëheqësit të QNR-së, është caktuar u. d, z. Besnik Buzhala

(Udhëheqës i Divizionit të Shërbimit Votues), në pozitën e Drejtorit të Departamentit të Çështjeve Ligjore, është caktuar u.d. znj. Emira Alushi (Zyrtare e Lartë Ligjore), dhe në pozitën e Drejtorit të Koordinimit në Terren është caktuar z. Skënder Qelaj (Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Suharekë).

Në vazhdim, lidhur me këtë raport u shtruan pyetje dhe u dhanë vlerësime e analiza nga anëtarët e KQZ-së. **Ilir Gashi**, foli rreth rregullës që bënë fjalë për financimin e subjekteve politike, dhe rreth ndryshimeve brenda kuadrit menaxhues në Sekretariat. **Sami Kurteshi**, diskutoi po ashtu rreth rregullave zgjedhore, dhe rreth çështjeve që lidhen me funksionalizimin e zyrave të KKZ-ve. **Arianit Elshani**, pyeti rreth tryezës së takimit me zyrtarët e KKZ-ve, dhe aktivitetet që priten të zhvillohen me zyrtarët komunalë. **Çemailj Kurtişi**, u interesua rreth bashkëpunimit të kryesuesve - zyrtarëve të KKZ-ve me përgjegjësit, kryetarët e komunave në mënyrë që bashkëpunimi të jetë më funksional.

Rreth këtyre çështjeve - pyetjeve, u përgjigj kryeshefi z. **Ahmetaj**: qoftë rreth problemeve me zyrat e KKZ-ve, dhe qoftë rreth ndryshimeve në rregulloret e KQZ-së. Më 23 mars, do të jetë takimi që do të organizohet në bashkëpunim me OSBE-në, tha z. Ahmetaj. Ai, po ashtu, tha se përgjatë komunikimit me Komisionin e Zgjedhjeve të Sllovenisë, afati i fundit për akreditim lidhur me vëzhgimin e këtyre zgjedhjeve, është 13 prilli mirëpo, duhet paraprakisht të dihet përbërja dhe numri i pjesëmarrësve.

3. Aktivitetet e ZRPPC:

Rekomandimit për dërgimin e Raporteve të Auditimit të partive Politike për vitin 2018-2020 në ATK:

Nexhmedin Hyseni, drejtor i ZRPP: Fillimisht, ju përshëndes meqë është hera e parë që ju drejtohem në këndvështrimin e pozicionit tim të ri, dhe duke e çmuar e duke i falënderuar të gjithë kolegët në punët paraprake që kemi bërë së bashku! Më lejoni, jo të ju premtoj, por të ju siguroj se puna e ime dhe e zyrës sipas mandatit ligjor bashkë me ekipin që është, do të jetë kryefjala që zyra do të punojë sipas mandatit ligjorë, drejtë dhe barabarësisht për të gjithë e bashkërisht! Prandaj, faleminderit të gjithëve...!

Në vazhdim, ish ushtruesja e detyrës së ZRPP, Valmira Selmani, paraqiti rekomandimin për KQZ-në të raportit të Auditimit të Partive Politike për vitin 2018-2020 në ATK. Ajo tha se, zyra e ka përgatitur këtë raport për vitet 2018-2020. Kurse, gjatë vitit 2021, në përputhje me ligjin, zyra ka pranuar raportet e financiare të subjekteve politike, dhe raportet e fushatës që janë audituar nga auditori i zgjedhur nga Kuvendi. Zyra, po ashtu ne kemi ndjekur edhe hapat e tjerë në përputhje me punën dhe obligimet e zyrës, si dhe bashkëpunimin me faktorët e tjerë relevant të brendshëm dhe të jashtëm.

Lidhur me këtë pikë, diskutoi anëtari Sami Hamiti, që tha se rekomandim është shqyrtuar në këshillin për çështje ligjore, dhe ne jemi akordua që të dërgohet në Administratën Tatimore të Kosovës. Ne, unanimisht e kemi aprovuar këtë rekomandim. Çdo subjekt, e ka numrin fiskal në ATK, prandaj ky është një vullnet por, edhe me ligj është e përcaktuar se kush, çka ka të drejtë në këtë drejtim...

Në fund, me 11 vota, u miratua rekomandimi i ZRPP-së.

4. Raport i Këshillave të KQZ-së

1.Këshilli për Çështje Ligjore

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal, në Rahovec dhe Gjakove:

Sami Hamiti: Njëra pikë, tashmë u shqyrtua dhe u miratua, kurse pika tjetër është lidhur me kërkesat për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal, në komunën e Rahovecit dhe të Gjakovës. Sipas shqyrtimit dhe analizës së zyrës ligjore, pasi është kompletuar materiali i nevojshëm, këshilli ka analizuar dhe kandidatët, i plotësojnë të gjitha kushtet ligjore për zëvendësim.

Kreshnik Radoniqi: Në komunën e Rahovecist, i dorëhequri Masar Popaj zëvendësohet Lirigzon Kastrati nga Veton Kurti nga subjekti politik LDK. Kush është për...?

Miratohet...

Kreshnik Radoniqi: Në komunën e Gjakovës, i dorëhequri Robert Marjakaj zëvendësohet nga Ardian Nushi nga PSHDK. Kush është për...?

Miratohet...

2.Këshilli për Buxhet dhe Financa

Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të KQZ-së për vitin 2023-2025:

Gordana Llaban: Në takimin e këshillit të buxhetit, kemi analizuar dhe shqyrtuar kornizën afatmesme të shpenzimeve të KQZ-së për vitin 2023-2025. KQZ, është e obliguar që Qeverisë së Kosovës, deri më 23 mars t'ia dërgojë raportin e shpenzimeve afatmesme të cilin, edhe e keni në imell. Ne, kemi diskutuar dhe

kemi dhënë mjaft sugjerime tona, ashtu si edhe disa plotësime dhe ndryshime. Kryesorja, korniza afatmesme paraqet buxhetin për vitin 2023, ndërsa dy vitet e tjera paraqesin vetëm vlerësimet. Pra, në këtë periudhë, edhe mund të ketë ndryshime ! Gjykojmë që vitin 2023, edhe pse nuk është i planifikuar si vit zgjedhorë, pasqyron buxhetin e shpenzimeve në vlerë prej 6, 750 102 euro.

Në vazhdim, znj. Llaban, paraqiti vlerësimet rreth shpenzimeve eventuale, përgatitjet, dhe çështjet e tjera që, janë vetëm propozimeve dhe se të gjitha shpenzimet, tani për tani janë vetëm shqyrtime dhe analiza lidhur me këtë kornizë...

Arianit Elshani: Për shkak të kohës së shkurtër për të trajtuar gjithë këtë dokument, kam disa komente në raport me ato që janë të përfshira në këtë planifikim. Dilemat e mai janë tek kodi buxhetor, tek DAP është anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare, pra tash kemi një gjendje tjetër meqë, pagesën që e kemi pasë për ACEEEO, tani nuk do ta bëjmë, duhet ta korrigjojmë! Tash kjo shumë, mund të largohet nga buxheti. Komentet rreth identifikimin elektronik të votuesve, projektet e e trajnimeve dhe çështje të tjera, z. Elshani i vuri në analizë me qëllim që të shihen mundësitë e organizimit, të kohës së organizimit, dhe përputhjes me kornizën buxhetore.

Në këtë pikë, diskutuan pastaj edhe Ilir Gashi, Alim Rama, Qemajl Kurtishi, Fazli Stolla, Sami Hamiti dhe Burim Ahmetaj.

Në fund, anëtarët e KQZ-së me dhjetë vota për dhe një abstenim (Arianit Elshani), miratuan në parim kornizën afatmesme të shpenzimeve të KQZ-së për vitin 2023-2025.

5. Komiteti i Auditimit

Sami Kurteshi, kryesues i komitetit të auditimit, tha se më 4 mars është mbajtur mbledhja e komitetit të auditimit. Kemi pasur tri dokumente të shqyrtuara, e në veçanti planin e punës së auditimit. Ne, ua kemi dërguar materialin. E kemi miratuar në takim, dhe pastaj, ishte plani i kontrollit të auditimit të brendshëm, dhe raporti vjetor i auditorit të brendshëm.

Plani i punës dhe raporti final i auditimit të vitit 2021, janë dy raporte që duhet t'i ketë KQZ, dhe pse jo, raporti mund edhe të publikohet !

Sami Hamiti: Për ne, është me rëndësi të kuptojmë se çka ka raporti i auditorit të brendshëm, çka është gjetur aty, cila është kontrolli i brendshëm në raport me operatorët etj.

Në këtë pikë ,diskutuan edhe Arianit Elshani, që tha se planet dhe raportet duhet të publikohen. Kurse, të dalurat që gjendet në raportet e auditorit, duhet të analizohen, përmirësohen dhe plotësohen. Sami Kurteshi, tha se ka avancime, sidomos në raport të bashkëpunimit të auditorit me menaxhmentin etj. Gjithashtu, diskutuan edhe Alim Rama, Nexhmedin Hyseni, Sylejman Gashi, auditor i brendshëm.

Në fund të diskutimeve me 11 vota për, miratohet raporti final i kontrollit të brendshëm të auditimit.

7. Të ndryshme.

Arianit Elshani, foli rreth kushteve dhe kërkoi që të merren masa rreth infrastrukturës në Sekretariat, aidi kartelave dhe rreth çështjeve të inventarit për punë më normale në objekt...

Për KQZ

Kryetari, z. Kreshnik Radoniqi
